

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup>

### FLETA SINTETIKE DRENAZHIMI

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup> është membranë drenazhimi prej polietileni me dendësi të lartë (HDPE), e konfiguruar në mënyrë të përshtatshme për lehtësimin e drenazhimit të ujërave nëntokësorë.

#### PËRDORIMET

Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup> përdoret si një shtresë mbrojtëse e sistemeve hidroizoluese dhe për lehtësimin e drenazhimit të ujit në strukturat nëntokësore si kopshtet, muret mbajtës, bazamente urash, etj. Mund të përdoret gjithashtu si një mbrojtje e sistemeve hidroizoluese në tunele, çati / tarraca të gjelbra, etj.

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë e lartë kimike
- Rezistencë ndaj depërtimit të rrënjëve
- Zgjidhje shumë ekonomike
- Instalim i lehtë
- Rezistencë e lartë mekanike

Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup> formon një hapësirë boshe midis elementit strukturor dhe materialit mbushës, duke mundësuar rrjedhjen e ajrit, ujit dhe avujve të ujit dhe duke përmirësuar sigurinë funksionale të hidroizolimit.

Për shkak të vetivë të shkëlqyera mekanike të tij, mbron shtresën hidroizoluese nga sforcimi i mundshëm mekanik dhe dëmtimet gjatë procesit të mbushjes.

#### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Polietilen me dendësi të lartë (HDPE)
Ambalazhi	Rulon: 2.00 m (gjerësi) x 30.00 m (gjatësi)
Paraqitja / Ngjyra	Rulonat Sipërfaqja: e sheshtë me ngritje në formë koni Trashësia e membranës: 0.4 mm Trashësia e produktit: 7.5 mm Ngjyra: kafe
Jetëgjatësia	Në kushte të duhura magazinimi, produkti nuk skadon.
Kushtet e magazinimit	Rulonat duhet të ruhen në kushte të thata, në pozicion vertikal ose horizontal, të mbrojtur nga shiu, dëbora, akulli, etj.
Përmasat	Gjatësia e gropës: 7.5 mm Hapësira e ajrit midis gropëzave: 5.8 lt/ m <sup>2</sup>
Trashësia	0.4 mm
Njësia e peshës	~ 400 gr/ m <sup>2</sup>

## TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	>120 KN/m <sup>2</sup>	(EN ISO 826 adp)
Rezistenca ndaj tërheqjes	>200 N/5cm (gjatësore) >200 N/5cm (tërthore)	(EN ISO 10319)
Zgjatimi	>20 N % (gjatësor) >20 N % (tërthor)	(EN ISO 10319)

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

### Struktura e sistemit

Produkte ndihmëse:

- Sika® Drain Profile - profil i posaçëm përfundimi me bazë polietileni me dendësi të lartë (HDPE), përmasa 2.00 m (gjatësi) x 7 cm (gjerësi)
- Sika® Drain Plugs & Nails - për fiksime
- Sika® MultiSeal - shirit hidroizolues i vetëngjithshëm për fiksime dhe sigurimin e mbivendosjeve midis fletëve.

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS

E pastër dhe e thatë, homogjene, pa vaj dhe graso, pluhur, grimca të lira dhe skaje të ashpra. Përpara instalimit të Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup>, duhet të jetë aplikuar sistemi i përzgjedhur i hidroizolimit. Nëse produkti i hidroizolimit është veshje, lëreni të thahet plotësisht përpara instalimit të Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup>. Sigurohuni që uji i drenazhimit të mund të rrjedhë tek toka ose në raste të rrjedhës së lartë të ujit nëpërmjet tubave të zakonshëm të drenazhimit dhe aggregateve kokërrtrasha pa kompaktim.

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

Fletët Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup> instalohen me ngritjet përballë elementit strukturor që do të mbrohet. Fiksoni membranat në krye të elementit strukturor, duke përdorur gozhda çeliku me distancë 25 cm midis tyre. Për të parandaluar hyrjen e dheut midis membranave, mbivendosni fletët me kujdes të veçantë. Gjerësia min. rekomanduar e mbivendosjes: 20 cm. Përdorni Sika® MultiSeal (shirit hidroizolues i vetëngjithshëm) për bashkimin e membranave dhe për fundet e membranave në krye të elementit strukturor.

## KUFIZIME

Pas instalimit dhe fiksimit të membranës, siguroni përfundimin e sipërm të Sika® Drain S 400g/m<sup>2</sup> me Sika® Drain Profile. Si një alternativë, për të parandaluar hyrjen e dheut tek hapësira bosh e formuar midis membranës dhe elementit strukturor të hidroizoluar, izoloni këtë hapësirë me izolues (p.sh. Sikaflex® Pro-3).

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Drain S 400g/m2

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020704990010000013

SikaDrainS400gm2-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf